

L I G J
Nr. 9464, datë 28.12.2005

PËR BUXHETIN E SHTETIT TË VITIT 2006

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

(i ndryshuar)

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 158 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

K R E U I
BUXHETI I SHTETIT

Neni 1

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Buxheti i Shtetit për vitin 2006 është:

Të ardhurat	229 932	milionë lekë
Shpenzimet	266 751	milionë lekë
Deficiti	36 819	milionë lekë

Buxheti i Shtetit përbëhet nga fondi i konsoliduar, buxheti i sigurimeve shoqërore dhe buxheti i sigurimeve shëndetësore.

Neni 2

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

A. Fondi i konsoliduar për vitin 2006 është:

Të ardhurat	192 632	milionë lekë
Shpenzimet	229 451	milionë lekë
Deficiti	36 819	milionë lekë .

Fondi i konsoliduar përbëhet:

A.1. Buxheti Qendror:

Të ardhurat	181 532	milionë lekë
Shpenzimet	218 351	milionë lekë.

A.2. Buxheti i pushtetit vendor:

Të ardhurat	23 100	milionë lekë
-------------	--------	--------------

Nga të cilat:

Granti i pakushtëzuar nga Buxheti Qendror	8 300	milionë lekë
Granti për investime nga Buxheti Qendror	3 700	milionë lekë
Shpenzimet	23 100	milionë lekë.

Neni 3

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

B. Buxheti i sigurimeve shoqërore për vitin 2006 është:

B.1. Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

Të ardhurat, gjithsej 50 271 milionë lekë
Të cilat:
- Nga kontributet 33 444 milionë lekë
- Nga transferimet nga Buxheti i Shtetit 16 827 milionë lekë
Shpenzimet 50 271 milionë lekë

Paga minimale, për efekt të pagesës së kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, deri në fund të vitit 2006 është 13140 lekë në muaj. Për vitin 2006 teprica e të ardhurave, sipas degëve të sigurimit shoqëror, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

B.2. Skema e sigurimit suplementar
Të ardhurat, gjithsej 3 534 milionë lekë
Të cilat:
- Nga kontributet 159 milionë lekë
- Nga transferimet nga Buxheti i Shtetit 3 375 milionë lekë
Shpenzimet 3 534 milionë lekë.

Neni 4

C. Buxheti i sigurimeve shëndetësore për vitin 2006 është:
Të ardhurat gjithsej 6 502 milionë lekë;
Të cilat:
- nga kontributet dhe të tjera 3 697 milionë lekë;
- nga transferimet nga Buxheti i Shtetit 2 805 milionë lekë;
Shpenzimet 6 502 milionë lekë.

Neni 5

Llogaritë bankare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor mbahen në Bankën e Shqipërisë.

Përdorimi dhe investimi i gjendjes së llogarive bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

KREU II

BURIMET PËR MBËSHTETJEN E SHPENZIMEVE TË FONDIT TË KONSOLIDUAR

Neni 6

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Të ardhurat e Fondit të Konsoliduar, sipas grupeve kryesore, janë:
Grantet 6 000 milionë lekë
Të ardhurat tatimore 159 000 milionë lekë
Të ardhurat jotatimore 16 532 milionë lekë
Të ardhurat e buxhetit vendor 11 100 milionë lekë.

Neni 7

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Kufiri i financimit të deficitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme është 26 797 milionë lekë, nga i cili 4 000 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit. Në rast mosrealizimi të të ardhurave të buxhetit dhe të të ardhurave nga privatizimi, huamarrja për financimin e deficitit të brendshëm prej 22 797 milionë lekësh nuk ndryshon. Këshilli i Ministrave

merr masa për kompensimin e diferencave nga burime suplementare ose nga shkurtimi i shpenzimeve. Kufiri neto i financimit nga burime të huaja është 10 022 milionë lekë. Ky kufi mund të ndryshojë gjatë vitit, brenda limiteve të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji.

KREU III SHPENZIMET E FONDIT TË KONSOLIDUAR

Neni 8

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Shpenzimet e fondit të konsoliduar, sipas drejtimeve kryesore, janë:

Shpenzimet korrente	166 782	milione lekë
Shpenzimet kapitale	58 668	milione lekë
Rezerva e Këshillit të Ministrave	2 000	milione lekë
Kontingjenca	2 000	milione lekë

Kufiri i shpenzimeve për ministrinë dhe institucionet, i ndarë në fonde të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara, është sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për institucionet e pavarura nga Këshilli i Ministrave kufiri i shpenzimeve, numri i punonjësve dhe fondi i pagave janë sipas tabelës 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet operative, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore, në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si dhe për organet e pushtetit vendor. Shpenzimet e pakryera në fund të vitit buxhetor transferohen në një llogari speciale si transfertë kapitale për t'u përdorur për shpronësimet.

Neni 9

Fondet e pakushtëzuara janë kufi maksimal i shpenzimeve.

Fondet e kushtëzuara përfshijnë shpenzimet për investime me burim financimet e huaja dhe shpenzimet nga të ardhurat që me ligj ose me akte të tjera nënligjore u përkasin ministrive dhe institucioneve të tjera buxhetore. Fondet e kushtëzuara me burim të brendshëm përdoren brenda vitit buxhetor.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të rishikojë të gjithë bazën ligjore të krijimit dhe të administrimit të të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore dhe të propozojë rregullimet përkatëse.

Brenda tremujorit të parë të vitit 2006 Këshilli i Ministrave vendos norma dhe standarde financiare për shpenzimet operative, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet buxhetore në varësi ose jo të Këshillit të Ministrave, si dhe për organet e pushtetit vendor.

Neni 10

(Ndryshuar paragrafi i fundit me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Numri maksimal i punonjësve buxhetorë më 1 janar 2006, sipas të cilit është përgatitur Buxheti i Shtetit i vitit 2006, është 110 000 punonjës.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë numrin e punonjësve buxhetorë për çdo ministri dhe institucion qendror, me përjashtim të numrit të punonjësve të institucioneve të pavarura, që përcaktohen në tabelën 1/1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi rezervë për koston e personelit prej 3 631 milionë lekësh shpërndahet nga Ministria e Financave, sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për rritjen dhe reformën e pagave në administratën publike, si dhe për korrigjimin e efekteve të kontributit të sigurimeve shoqërore.

Neni 11

Shpenzimet kapitale nga burimet e brendshme dhe nga burimet e huaja, sipas programeve, për çdo ministri dhe institucion qendror paraqiten në tabelën 2, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 12

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Fondi i kontingjencës prej 2 000 milionë lekësh përdoret tërësisht ose pjesërisht për uljen e deficitit. Përdorimi tërësisht për këtë qëllim bëhet kur të ardhurat nga burimet e brendshme realizohen sa janë parashikuar në buxhet. Përdorimi pjesërisht bëhet për diferencën ndërmjet fondit të kontingjencës dhe mosrealizimit të të ardhurave kur mosrealizimi është më i vogël se 2 000 milion lekë.

Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave prej 2 000 milionë lekësh përdoret për raste të paparashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Buxheti i Kuvendit është 962 milionë lekë, nga të cilat 240 milionë lekë investime. Detajimi i fondeve buxhetore bëhet nga Kuvendi në zbatim të ligjit për statusin e deputetit dhe të Rregullores së Kuvendit.

Neni 14

Fondet buxhetore për pushtetin gjyqësor paraqiten në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji. Buxheti i pushtetit gjyqësor administrohet nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr.8363, datë 1.7.1998. Bordi i kësaj Zyre mund të rishpërndajë deri në 10 për qind të totalit të fondeve për çdo nivel të pushtetit gjyqësor, si dhe të miratojë çdo transferim ndërmjet gjykatave të të njëjtit nivel, duke respektuar raportet ndërmjet shpenzimeve korrente dhe shpenzimeve kapitale, të paraqitura në tabelën 3, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 15

Transfertat e pakushtëzuara, që Buxheti Qendror ia transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet organeve të pushtetit vendor, sipas formulës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Fondi i kompensimit nga totali i transfertës së pakushtëzuar dhe granti ekualizues përdoren nga Ministria e Financave, në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Shuma e transfertës së pakushtëzuar, për çdo organ të pushtetit vendor, është paraqitur në tabelën 4, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Mënyra e financimit të funksioneve të përbashkëta në sektorin e arsimit, të shëndetësisë, të çështjeve sociale dhe të shërbimeve publike jepet në aneksin 3 dhe fondet për investime në sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë jepen në aneksin 3/1, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Fondet për grantet konkurruese shpërndahen sipas aneksit 4, që i bashkëlidhet këtij ligji. Çështjet financiare të transferimit të ujësllësve jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë buxhetin e vet brenda vitit kalendarik, duke u bazuar në fondet që u vihen në dispozicion, sipas këtij neni ose akteve të tjera ligjore dhe nënligjore dhe në të ardhurat që me ligj u përkasin atyre. Buxheti i plotë i njësive të qeverisjes vendore dhe vendimet e tjera të këshillave të këtyre njësive, që kanë lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, bëhen publike.

Neni 16

Kufiri i shpenzimeve, sipas tabelave 1, 1/1 e 2, që i bashkëlidhen këtij ligji, mund të rishpërndahet gjatë vitit ndërmjet ministrive/programeve nga Këshilli i Ministrave deri në masën 5 për qind të çdo shume të paraqitur në këto tabela.

Neni 17

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2006 është 64 462 milionë lekë, i ndarë si më poshtë:

1. Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit, si rezultat i zbatimit të buxhetit të vitit 2006, është 45 727 milionë lekë, nga i cili:

- për kreditë e jashtme të drejtpërdrejta të Këshillit të Ministrave është 22 930 milionë lekë;
- për financimin e brendshëm të deficitit buxhetor është 22 797 milionë lekë.

2. Kufiri për rritjen vjetore të garancive të shtetit në dobi të palëve të treta përfituese është 8 516 milionë lekë.

3. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të jashtme të papaguara, është 7 219 milionë lekë.

4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i mbulimit të diferencave nga rivlerësimi i valutave, është 3 000 milionë lekë, i cili emetohet në përputhje me shumatat e rezultuara pas certifikimit të bilancit të Bankës së Shqipërisë.

Neni 18

Ngarkohet Ministria e Financave të nxjerrë udhëzime për zbatimin e këtij ligji.

Neni 19

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2006.

Shpallur me dekretin nr. 4745, datë 13.1.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

ANEKS 1

FORMULA E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR - KRITERET DHE KOEFICIENTET

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
I. Transferta e Pakushtëzuar Gjithsej (9.8 miliard lekë) ëTPGJ] Transferta e pakushtëzuar për një bashki ose komunë është e barabartë me shumën përkatëse të pjesës “a” që rezulton nga aplikimi i formulës së veçantë mbi shumën “A” (Shuma A = 8,3 miliardë lekë) plus shumën “b” që rezulton nga aplikimi i formulës së veçantë mbi totalin “B” të transfertës së pakushtëzuar (Shuma B = 1,5 miliardë lekë). Qarqet përfitojnë vetëm nga shuma “A” e transfertës sipas formulës përkatëse.			
A. Alokimi i pjesës A të Transfertës së Pakushtëzuar – (Shuma A = 8.3 miliardë lekë) ëTPA]			
Pjesa e Qarqeve [Q]	8.5%	705.500	Ky raport u alokon Qarqeve fonde për shpenzimet e tyre administrative, për mirëmbajtje dhe investime të rrugëve rurale dhe për shpenzime të tjera operative.
Pjesa për	91.5%	7.594.500	Për të siguruar financimin e funksioneve

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
Bashkitë/Komunat [B/K] 1. Shpërndarja e pjesës së Bashkisë/Komunës ëB/K]			kryesore të ushtruara nga niveli i parë i QV.
Grant i përgjithshëm [GP] = [GP] * 1.00	100%	7.594.500	Pjesa e plote për B/K alokohet në hapin e parë në grantin e përgjithshëm. Nuk alokohen fonde të veçanta për kompensim; fondi i kompensimit krijohet nëpërmjet kompensimit të tranzicionit (shih më poshtë)
2. Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm për Bashkitë/Komunat			
Popullsia [P-B/K] = [GP-B/K] * 0.70	70.0%	5.316.150	Ky është kriteri dominant, pasi popullsia është një indikator i lidhur ngushtë me shpenzimet dhe nevojat për shërbime. Alokimi i ëP-B/K/] ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo Bashkie/Komune kundrejt popullsisë totale. Për vitin 2006 të dhënat e popullsisë janë marrë nga regjistrimet e bëra për zgjedhjet e 3 Korrikut 2005.
Sipërfaqja e komunave [S-K] = [GP-B/K] * 0.15	15%	1,139.175	Ky element është i aplikueshëm vetëm për komunat. Komunë me sipërfaqe më të madhe nënkupton (për të gjithat kushtet e tjera të barabarta) se ka rrugë më të gjata dhe sfida të tjera infrastrukturore që kushtojnë. Të dhënat e sipërfaqeve të komunave janë marrë nga Instituti i Gjeografisë. Alokimi i ëS-K] ndahet proporcionalisht me sipërfaqen relative të çdo komune kundrejt sipërfaqes totale. Për 178 komuna malore sipërfaqja është llogaritur si totali i sipërfaqes bazë shtuar me pesë herë.
Shërbimet Urbane [SU-B] = [GP-B/K] * 0.15	15%	1,139.175	Ky koeficient për simetri me komunat është 15 % e totalit të fondit dhe ndahet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo bashkie kundrejt popullsisë totale të bashkive. Për Bashkitë e vlerësuara si bashki në nevojë koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2 herë numrin faktik të popullsisë. Për bashki malore, koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar me 2 herë numrin faktik të popullsisë. Për bashkitë malore e njëkohësisht në nevojë koeficienti i shërbimeve urbane është llogaritur duke shtuar 4 herë numrin faktik të popullsisë për këto bashki.

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
3. Rregullimi i Ekualizimit Fiskal për Bashkitë dhe Komunat			
Ekualizimi Fiskal (B/KPCR-NPCR)*(+/- 30%)*Popullsia [PCR] -TAPF = Të ardhura për frymë N = nacionale	30%	1,454,936	Ekualizimi fiskal bazohet në të ardhurat faktike nga tatimi vendor mbi biznesin e vogël, tatimi i thjeshtëzuar mbi të fitimin (të ardhurat faktike të biznesit të vogël vitit 2004 të korrigjuar me koeficientin (0.75), taksën e regjistrimit të automjeteve (faktike 2004). B/K që kanë të ardhura për frymë më të larta se sa të ardhurat nacionale për frymë kontribuojnë 30% të diferencës ndërmjet të dyjave shumëzuar me popullsinë e tyre. B/K që kanë të ardhura për frymë me të ulëta se të ardhurat nacionale për frymë marrin 30% të së njëjtës diferencë të llogaritur në të njëjtën mënyrë.
Rregullimi tranzitor (rezultati negativ kundrejt vitit 2005) (B/KR2005-B/KR2006)*(0.100) R = të ardhura për një vit të dhënë	Kufiri 0.00% koeficient i 100%	371,249	B/K të cilat, pas rezultateve të ekualizimit fiskal kanë një grant që është me i ulët se në vitin 2005 kompensohen për diferencën në masën 100 %
Rregullimi tranzitor (rezultatet pozitive kundrejt vitit 2005)	Kufiri >20% Koeficienti 1.20%	(841.076)	Pas rezultateve të ekualizimit fiskal, ato B/K të cilat përfitojnë një rritje mbi 20% krahasuar me vitin 2005, kontribuojnë për rritjen e garancisë minimale për frymë në masën e tejkallimit mbi 20% krahasuar me rezultatin e transfertës për vitin 2005.
Kompensimi i garancisë minimale për frymë.	B – 2,900 minimumi për frymë K – 1,900 minimum për frymë	412,190	Për të siguruar një të ardhur të garantuar minimale për frymë, ky kompensim krahason të ardhurat përfundimtare për frymë (grantit të përshtatur për tranzicion, plus të ardhurat fiskale të listuara më përpara) me garancinë minimale prej (1900 lek/për frymë për komunat, 2900 lek/për frymë për bashkitë). Bashkitë ose Komunat marrin diferencën ndërmjet të dyjave, shumëzuar me popullsinë e tyre.
Fondi Neto i Kompensimit për bashkitë dhe komunat [FNK-B/K]		57,637	Ky fond është produkt i elementeve të mëposhtme: - Kompensimi tranzitor për rezultat negativ + Kompensimi tranzitor për rezultat pozitiv - Kompensimi i garancisë minimale për frymë

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
			Përdorimi i fondit kompensues për B/K bëhet sipas kriterëve të parashikuara, siç përshkruhet në Aneksin 3.
4. Shuma Finale e Grantit të Përgjithshëm A për Bashkitë dhe Komunat			
Shuma në total e shpërndarjes së grantit për bashkitë dhe komunat		7,536,863	
5. Shpërndarja e Pjesës së Grantit A për Qarqet			
Granti i Përgjithshëm për Qarqet	98%	691,390	Për financimin e funksioneve bazë të qarqeve.
Fondi i Kompensimit për Qarqet	2%	14,110	Për financimin e rasteve të veçanta të shpenzimeve të qarqeve
6. Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm A për Qarqet			
Shuma fikse [SF-Q] = [Q] * 0.15	15%	103,709	Shuma fikse alokon një shumë të barabartë për çdo qark . Shuma në total [SF-Q] ndahet barabar mes qarqeve (pjesëtohet me numrin e qarqeve 12)
Popullsia [P-Q] = [Q] * 0.25	25%	172,848	Tipet e shërbimeve të siguruara nga qarku kanë një korrelacion negativ me popullsinë. Dhënia e një peshe më të madhe këtij kriteri do të penalizonte padrejtësisht më tepër qarqet më të varfra dhe me më pak banorë. Alokimi i [P-Q] bëhet proporcionalisht me popullsinë relative të çdo qarku kundrejt totalit të popullsisë.
Treguesi gjeografik [KG-Q] = [Q] * 0.30	30%	207,417	Ky është një tregues i rëndësishëm që merr parasysh avantazhet dhe dizavantazhet natyrore të vendndodhjes së qarkut. Për të karakterizuar tre zonat tipike të vendit: fushore – kodrinore – malore u përdor një shkallë përkatëse 1-3-5.. Sa më e lartë shkalla aq më të mëdha fondet që do të alokohen për këtë koeficient. Alokimi i [KG-Q] bëhet proporcionalisht me raportin e shkallës së qarkut kundrejt shumës së shkallëve për të gjithë qarqet (32).
Koeficienti i Rrugës [R-k] = [Q] * 0.30	30%	207,417	Alokimi [ëKR] ndahet proporcionalisht me gjatësinë relative të rrugëve për secilin qark, kundrejt gjatësisë totale.
7. Fonde të disponueshme për kompensim			
a. Kompensim për B/K		57,637	Përdorimi i këtyre fondeve të

Kriteri	Koeficienti	Vlera (në mijë lekë)	Arsyeja themelore
b. Kompensimi për Q TOTALI		14,110 71,747	kompensimit do të bazohet në kriteret e caktuara paraprakisht dhe nga marrëveshja reciproke ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave.
B. Alokimi i pjesës B të Transfertës së Pakushtëzuar për Bashkitë dhe Komunat (Shuma B =1.8 miliard) – [TPB]			
Koeficienti i popullsisë	100%	1,500,000	Kriteri i vetëm i shpërndarjes është pesha relative e popullsisë bazuar në parimin fonde të barabarta për frymë. Pas aplikimit të këtij kriteri rezultati korrigjohet me tre koeficientet e mëposhtëm.
Koeficienti i drejtësisë (K-D)	0.6		Ky koeficient përdoret për të korrigjuar efektin e diferencave të shpërndarjes së investimeve për rrugët rurale dhe urbane gjatë viteve 2002-2005. Aplikimi i koeficientit merr në konsideratë në mënyrë proporcionale fondet e përfituara nga çdo B/K në vitet 2002-2005 për fryme krahasuar me mesataren kombëtare për fryme. Bashkitë/komunat mbi këtë mesatare marrin mesatarisht në vitin 2006 fonde = $(1-0.6)$ shumëzuar me mesataren kombëtare për frymë 2006 dhe popullsinë përkatëse. Bashkitë/komunat nën mesataren kombëtare për frymë 2002-2005 marrin si më sipër por me koeficientin $(1+0.6)$.
Kriteri njësive malore (K-M)	5		Ky koeficient favorizon bashkitë/komunat malore nëpërmjet shumëzimit të popullsisë përkatëse të bashkisë me koeficientin 5.
Kriteri i bashkive në nevojë	2		Ky koeficient favorizon bashkitë në nevojë, nëpërmjet shumëzimit të popullsisë përkatëse të bashkisë me koeficientin 2.

ANEKS 2

KRITERET E SHPËRNDARJES SE FONDIT TË KOMPENSIMIT

Nivelet e Pushtetit Vendor	Kriteret
A. Fonde vetëm për bashkitë dhe komunat	- kompensimi për ripërshtatjen e kapacitetit fiskal, -kompensimi bazuar në kriterin e varferisë (SKZHES),
B. Fonde vetëm për qarqet	-disa shpenzime operative që mund të

	nevojiten gjate vitit.
--	------------------------

Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave shpallin dhe njoftojne cdo bashki, komune dhe qark per sasine e fondeve dhe arsytet e shperndarjes se ketyre fondeve.

Procedurat per alokimin e ketij fondi percaktohen ne udhezimin e zbatimit te buxhetit te vitit 2006.

ANEKS 3

I.Funksione te Perbashketa ne Sektorin e Arsimit dhe te Shendetesise

1.SEKTORI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR:

Pagesa e pagave te mesuesve: Bashkite dhe komunat autorizohen te bejne pagesen e pages se mesuesve te sistemit para-universitar qe punon ne komunitetin e tyre sipas normave, menyres dhe afateve te percaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkences/Drejtorite Arsimore. Bashkite dhe komunat e permbushin kete funksion si nje sherbim administrativ. Ministria e Arsimit dhe Shkences jep te gjitha fondet e kerkuara per te paguar pagat e mesuesve, siç percaktohet ne aktet ligjore dhe nenligjore ne fuqi. Bashkite dhe komunat nuk duhet te japin ndonje fond nga buxheti i tyre per kete qellim. Shpenzimet per pagat e mesuesve nuk perbejne nje shpenzim per bashkite dhe komunat.

Funksionimi dhe mirembajtja e ambjenteve te arsimit para-universitar: Bashkite dhe komunat kane kompetence te plote per te siguruar mirembajtjen e te gjitha ambienteve te arsimit para-universitar ne komunitetin e tyre. Fondet per mirembajtjen e ambienteve te arsimit para-universitar jane te perfshira ne transferen e pakushtezuar qe i jepet bashkive dhe komunave nga Buxheti i Shtetit. Çdo bashki dhe komune vendos nivelin e financimit qe ajo akordon per kete funksion nga granti i pakushtezuar i dhene nga buxheti i Shtetit, si dhe nga burime te tjera te disponueshme ne buxhetin e tyre. Ministria e Arsimit dhe Shkences pergatit dhe nxjerr standarte minimale kombetare te sigurise dhe shendetit te zbatueshme per ambjentet e arsimit para-universitar. Keto standarte nuk duhet te kufizojne vendimmarrjen e bashkive dhe komunave ne fushat me interes te qarte vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirembajtjen e ambjenteve te arsimit para-universitar miratohen si pjese e buxhetit te cdo bashkie dhe komune.

Investimi

Ne zbatim te VKM nr.632, date 4.10.2004 "Per Miratimin e Dokumentit per Politikat e Decentralizimit ne Sektorin e Arsimit Parauniversitar", ne buxhetin e 22 bashkive dhe ne 12 qarqet per njesite e tjera te qeverisjes vendore per vitin buxhetor 2006 do te jet nje ze i vecante i buxhetit te shtetit "Granti i kushtezuar per ndertim, rikonstruksion dhe pajisje te ambienteve te arsimit parauniversitar". Bashkite, sipas Aneksit 3.1, per investimet ne territoret e tyre, dhe keshillat e qarqeve per investimet ne territoret e komunave dhe bashkive te patreguara ne menyre te vecante, jane pergjegjese per perdorimin e ketij buxheti.

Njesite e qeverisjes vendore mund te financojne nga te ardhurat e veta per ndertim, rikonstruksion dhe pajisje te kopshteve dhe shkollave te arsimit parauniversitar. Bashkite dhe keshillat e qarqeve pergjigjen per realizimin e investimeve te reja ndertimore, riparimet kapitale dhe paisjet e ambienteve te arsimit parauniversitar me fonde nga buxheti i shtetit, fondet e veta apo nga donatoret, mbi bazen e planit vjetor dhe duke respektuar standartet e vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Shkences.

Ministria e Arsimit dhe Shkences, nepermjet Drejtorive Arsimore, monitoron, vlereson dhe kontrollon zbatimin e standarteve te vendosura nga ajo per rikonstruksion, ndertim dhe pajisje te ambienteve te arsimit parauniversitar.

Ministri i Financave, Ministri i Arsimit dhe Shkences dhe Ministri i Brendshem per proçedurat e miratimit dhe zbatimit te buxhetit te investimeve per rikonstruksion, ndertim dhe pajisje te ambienteve te arsimit parauniversitar nxjerrin nje udhezim te vecante.

2.SEKTORI I KUJDESIT PARESOR SHENDETESOR:

Pagesa e pagave te personelit: Bashkite dhe komunat autorizohen te bejne pagesen e pagave te punonjesve te personelit qe punon ne qendrat shendetesore publike dhe poliklinikat ne komunitetin e tyre sipas normave, menyres dhe afateve te percaktuara. Bashkite dhe komunat e permbushin kete funksion si nje sherbim administrativ. Ministria e Shendetesise jep te gjitha fondet e kerkuara per te paguar pagat e personelit. Bashkite dhe komunat perdorin fondet e marra nga ky delegim vetem per pagat e personelit sipas afateve te percaktuara nga Ministria e Shendetesise. Bashkite dhe komunat nuk duhet te japin ndonje fond nga buxheti i tyre per kete qellim. Shpenzimet per pagat e personelit nuk perbejne nje shpenzim per bashkite dhe komunat.

Funksionimi dhe mirembajtja e ambjenteve te sherbimit paresor shendetesor

Fondet per mirembajtjen e ambjenteve te sherbimit paresor shendetesor dhe per shpenzimet e tjera operative shperndahen nga Ministria e Shendetesise nepermjet institucioneve te saj si fonde te deleguara.

Investimi

Ne zbatim te VKM nr.636, date 30.09.2004 "Per miratimin e Dokumentit te Politikave te Decentralizimit ne Fushen e Kujdesit Shendetesor Paresor dhe Mbrojtjen e Shendetit Publik", ne buxhetin e 12 qarqeve per vitin buxhetor 2006, do te jete nje ze i vecante i buxhetit te shtetit "Granti i kushtezuar per ndertim dhe rikonstrukcion te qendrave shendetesore dhe ambulancave per sherbimin paresor shendetesor". Keshillat e qarqeve per investimet ne territoret e komunave dhe bashkive te tyre jane pergjegjese per perdorimin e ketij buxheti.

Njesite e qeverisjes vendore mund te financojne nga te ardhurat e veta per ndertimin dhe rikonstrukcionin e qendrave shendetesore dhe ambulancave te sherbimit paresor shendetesor. Keshillat e qarqeve pergjigjen per realizimin e investimeve te reja ndertimore dhe riparimet kapitale me fonde nga buxheti i shtetit, fondet e veta apo nga donatoret, mbi bazen e planit vjetor dhe duke respektuar standartet e vendosura nga Ministria e Shendetesise.

Ministria e Shendetesise monitoron dhe kontrollon zbatimin e standarteve te vendosura nga ajo per rikonstrukcion dhe ndertim te qendrave shendetesore dhe ambulancave per sherbimin paresor shendetesor.

Ministri i Financave, Ministri i Shendetesise dhe Ministri i Brendshem per proçedurat e miratimit dhe zbatimit te buxhetit te investimeve per rikonstrukcion dhe ndertim te qendrave shendetesore dhe ambulancave te sherbimit paresor shendetesor nxjerrin nje udhezim te vecante.

3.NDIHMA EKONOMIKE DHE SHERBIMET E PERKUJDESIT SHOQEROR:

Fondet per Ndihmen Ekonomike .

Ne zbatim te VKM nr.637, date 30.09.2004 "Per Miratimin e Dokumentit te Politikave te Decentralizimit ne fushen e Ndhmes Ekonomike dhe te Sherbimeve te Perkujdesit Shoqeror", fondet e ndihmes ekonomike ne buxhetin e vitit 2006, jane fonde te kushtezuara ne kesh per familjet ne nevoje, si dhe fonde te kushtezuara per pune e sherbime ne komunitet.

Ne baze te kerkesave te paraqitura nga njesite e qeverisjes vendore per vitin 2006, Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta programon ne fillim te vitit fondet e ndihmes ekonomike (ndihme ne kesh per familjet ne nevoje ose per pune dhe sherbime ne komunitet) per çdo njesi te qeverisjes vendore.

Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta i delegon fondet e ndimes ekonomike si grante te kushtezuara per çdo njesi te qeverisjes vendore qe ne fillim te vitit.

- Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta çel ne thesar nje here ne dy muaj, fondet qe do shperndahen ne kesh familjeve ne nevoje nga bashkite dhe komunat.

- Fondet e ndihmes ekonomike te cilat destinohen ne njesite e qeverisjes vendore qe kushtezojne Ndhmen Ekonomike me pune e sherbime ne komunitet me kohe te plote ose te pjeseshme, çelen nje here ne 4 muaj mbi bazen e vleresimit te projekteve te paraqitura nga njesite e qeverisjes vendore.

Te gjitha fondet e kursyera si rezultat i perdorimit me efektivitet te ndihmes ekonomike do te jene kompetence e perdorimit te njesise se qeverisjes vendore.

Fondet e ndihmes ekonomike qe shperndahen ne njesite e qeverisjes vendore behen te njohura per te gjitha bashkite dhe komunat. Kriteret e parimet e perdoruara per shperndarjen e ketyre fondeve behen publike per te gjitha njesite e qeverisjes vendore.

Fondet per Pagesen e Personave me Aftesi te Kufizuar

Ne baze te vleresimit te kerkesave (nga komisionet mjeko ligjore) te paraqitura nga njesite e qeverisjes vendore. Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta programon qe ne fillim te vitit fondet per pagesen e personave me aftesi te kufizuar per çdo bashki dhe komune ne formen e grantit te kushtezuar.

Çelja ne thesar e fondeve per pagesen e personave me aftesi te kufizuar behet nga Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta çdo 2 muaj mbi bazen e vleresimit te komisioneve mjekesore.

Fondet per pagesen e personave me aftesi te kufizuar qe shperndahen ne njesite e qeverisjes vendore behen te njohura per te gjitha bashkite dhe komunat. Kriteret e parimet e perdoruara per shperndarjen e ketyre fondeve behen publike per te gjitha njesite e qeverisjes vendore.

Fondet per Perkujdesjen Shoqerore

Financimi i sherbimeve te perkujdesit shoqeror qe realizohen nga bashkite komunat dhe qarku, do te behet nga buxheti i shtetit si dhe te ardhurat vendore. Fondet nga buxheti i shtetit jepen ne formen e grantit te kushtezuar nga Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta qe ne fillim te vitit ne perputhje me vleresimin e nevojave ne baze te kerkesave dhe projekteve te paraqitura nga njesite e qeverisjes vendore dhe fondeve ne dispozicion.

Bashkite dhe komunat administrojne sherbimet e perkujdesit shoqeror per qendra te perkujdesit qe ju sherbejne individeve, banore te bashkise apo komunes si dhe sherbimet e perkujdesit per keta individe.

Qarqet administrojne sherbimet e perkujdesit shoqeror per qendra te perkujdesit qe ju sherbejne individeve te disa njesive te qeverisjes vendore ne perberje te qarkut.

Fondet per perkujdesin shoqeror qe shperndahen ne njesite e qeverisjes vendore behen te njohura per te gjitha bashkite dhe komunat. Kriteret e parimet e perdoruara per shperndarjen e ketyre fondeve behen publike per te gjitha njesite e qeverisjes vendore.

II. Fondet e shperndara nga Ministrit e linjes

Sistemet e Ujesjellesave te transferuara ne pushtetin vendor dhe atyre ne vazhdim qe do transferohen

Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit te beje shperdarjen e subvencioneve per ndermarrjet e transferuara gjate vitit 2004, 2005 dhe ato qe do te transferohen ne vitin 2006 ne njesite e qeverisjes vendore sipas te njejtave kriteret dhe parime qe zbatohen per te gjitha ndermarrjet e ujesjellesave.

Subvencionet per sistemet e transferuara te behen te njohura per te gjitha bashkite dhe komunat.

Aneksi 3-1

1. Granti i kushtëzuar për ndërtim, rikonstruksion dhe pajisje të ambientmteve të arsimit parauniversitar.

A. Ndarja e Investimeve për Qarqet dhe disa Bashki

Nr.	Keshillat e Qarqeve dhe Bashkite	Totali
1	Keshilli i Qarkut Berat	62,980
	Bashkia Berat	33,000
	Bashkia Kuçove	9,817
	Bashkia Çorovode	14,043
2	Keshilli i Qarkut Diber	66,000
	Bashkia Peshkopi	26,000

3	Keshilli i Qarkut Durres	54,721
	Bashkia Durres	60,000
	Bashkia Kruje	7,079
4	Keshilli i Qarkut Elbasan	156,200
	Bashkia Elbasan	60,000
5	Keshilli i Qarkut Fier	83,421
	Bashkia Fier	50,000
	Bashkia Lushnje	10,999
6	Keshilli i Qarkut Gjirokaster	31,992
	Bashkia Gjirokaster	25,000
	Bashkia Permet	6,058
	Bashkia Tepelene	6,110
7	Keshilli i Qarkut Korçe	98,049
	Bashkia Korçe	40,000
	Bashkia Pogradec	12,031
8	Keshilli i Qarkut Kukes	47,400
	Bashkia Kukes	57,000
9	Keshilli i Qarkut Lezhe	83,110
	Bashkia Lezhe	25,000
	Bashkia Laç	11,950
10	Keshilli i Qarkut Shkoder	115,320
	Bashkia Shkoder	80,000
11	Keshilli i Qarkut Tirane	192,834
	Bashkia Tirane	53,500
	Bashkia Kavaje	24,666
12	Keshilli i Qarkut Vlore	68,077
	Bashkia Vlore	60,000
	Bashkia Sarande	7,643
Shuma		1,740,000

Shënim: Në fondet e përcaktuara për Këshillat e Qarqeve përfshihen fondet për Komunitet dhe Bashkitë që nuk janë listuar në tabelën e mësipërme.

B. Ndarja e Grantit sipas Qarqeve

ne 000/leke

Nr.	Qarku	Totali
1	Berat	20,600
2	Diber	31,000
3	Durres	15,400
4	Elbasan	25,800
5	Fier	20,600
6	Gjirokaster	26,800
7	Korce	31,000
8	Kukes	26,800
9	Lezhe	15,400

10	Shkoder	34,100
11	Tirane	51,000
12	Vlore	21,500
Shuma		320,000

ANEKS 4

FONDET PËR GRANTET KONKURUESE DHE SHPËRNDARJA E TYRE

Fondet e buxhetit të shtetit të akorduara për Ministritë e linjës dhe që financojnë projekte që sipas ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" janë funksione të pushtetit vendor do të ndahen, monitorohen dhe kontrollohen në bashkëpunim me përfaqësuesit e pushtetit vendor. Ministritë i akordojnë këto fonde për pushtete vendore të caktuara bazuar në një sistem konkurrues të hapur e transparent sipas kriterëve të përcaktuara në këtë aneks.

I. Fondet buxhetore për grantet konkurruese përbëhen nga fonde të buxhetit të shtetit, akorduar ministrive ose institucioneve, të destinuara për t'u përdorur për shpenzime kapitale të lidhura me funksionet e veta të njësive të qeverisjes vendore. Grantet konkurruese u akordohen njësive të veçanta të qeverisjes vendore ose një subjekti të kompetencave të përbashkëta.

II. Kriteret dhe procedurat e shpërndarjes së fondeve për grantet konkurruese mes njësive të qeverisjes vendore nga institucionet qendrore të përcaktuara në këtë aneks janë:

- Shkalla e ndikimit të pritshëm në zhvillimin ekonomik e social si dhe shkalla e përputhshmërisë me përparësitë vendore dhe/ose rajonale të zhvillimit.

- Shkalla e ndikimit në reduktimin e varfërisë dhe e rritjes së aksesit në shërbimet bazë

- Shkalla e nxitjes së bashkëpunimit mes njësive të qeverisjes vendore

- Niveli i pjesëmarrjes të komunitetit në vendimmarrje dhe me kontribute

- Fondi lidhet me koston lokale të një financimi të huaj

- Projekte në vazhdim, për të cilat ka detyrime kontraktore

- Cilësitë teknike të projekteve të propozuara nga njësitë e qeverisjes vendore

III. Secili institucion qendror vendos në bazë të politikave dhe strategjive të tij sektoriale për fondet që do të akordojë për njësitë e qeverisjes vendore për vitin 2006, në përputhje me kriteret e pikës II.

Ministritë përkatëse, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe shoqatat përfaqësuese të njësive të qeverisjes vendore do të përcaktojnë indikatorët e kriterëve konkurruese dhe marrin vendimin e akordimit të fondeve bazuar në këto kriterë. Akordimi i fondeve sipas kësaj procedure të bëhet brenda datës 1 Mars 2006.

ANEKS 5

ÇESHTJE FINANCIARE TË TRANSFERIMIT TË UJËSJELLESAVE

1. Transferimi i ujësjellësve në pronësi e përgjegjësi të njësive të qeverisjes vendore do të kryhet gjatë vitit 2006 sipas një programi pune të konsultuar me përfaqësuesit e njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi për autonominë vendore e decentralizimin e sektorit të ujësjellësve.

2. Transferimi i ujësjellësve bazohet në një proces analize rast për rast, i cili synon zgjidhjen më të përshtatshme në përputhje me rrethanat përkatëse të çdo njësie vendore e çdo ujësjellësi. Ujësjellësit që furnizojnë me ujë të pijshëm më shumë se një njësi të qeverisjes vendore, për sa është e mundur dhe e përshtatshme, transferohen në bashkëpronësi të këtyre njësive vendore. Transferimi në pronësi të njësive të qeverisjes vendore nënkupton edhe mënyrën e transferimit në pronësi të këtyre njësive të aksioneve të shoqërive të ujësjellësve.

3. Transferimi i ujësjellësve gjatë 2006 bashkëshoqërohet rast-për-rast me përcaktimin

e fondit përkatës të subvencionit për shpenzime operative dhe kapitale që i jepet bashkisë/komunës përkatëse deri në fund të vitit, si pjesë e fondit total të destinuar për sektorin.

4. Ministria e Punëve Publike, Transportit e Telekomunikacionit së bashku me Ministrinë e Brendshme ngarkohen të nxjerrin udhëzime zbatuese dhe një plan të detajuar pune të procesit të realizimit të transferimit të ujësllësve.

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Tab.1

ne 000/Leke

Kodmin	Buxheti i vitit 2006 sipas Ministrive dhe Institucioneve (ne mije Leke)	Fonde te pakushtezuara	Fonde te kushtezuara	Totali
1	Presidenca	144,000	0	144,000

2	Kuvendi	962,000	0	962,000
3	Keshilli Ministrave	565,137	500,000	1,065,137
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	1,104,400	3,655,600	4,760,000
5	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mrojtjes se Konsumatorit.	3,482,450	1,789,050	5,271,500
6	Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	23,520,940	7,170,560	30,691,500
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	121,000	219,000	340,000
10	Ministria e Financave	810,500	23,460	833,960
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	23,535,590	2,792,410	26,328,000
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	1,413,200	316,900	1,730,100
13	Ministria e Shendetesise	17,449,710	1,868,290	19,318,000
14	Ministria e Drejtesise	2,548,542	1,147,208	3,695,750
15	Ministria e Puneve te Jashtme	1,441,000	20,000	1,461,000
16	Ministria e Brendshme	12,033,909	1,242,204	13,276,113
17	Ministria e Mbrojtjes	13,084,762	1,134,238	14,219,000
18	Sherbimi Informativ Shtetor	1,034,982	15,018	1,050,000
19	Drejtoria e Radio Televizionit	300,000	0	300,000
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	144,000	8,000	152,000
21	Drejtoria e Rezervave te Shtetit	110,000	5,000	115,000
22	Akademia e Shkences	575,000	37,000	612,000
24	Kontrolli Larte i Shtetit	235,000	0	235,000
25	Ministria e Punes, Ceshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	32,055,600	445,400	32,501,000
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	1,031,800	575,886	1,607,686
27	Agjensia Kombetare e Privatizimit	27,000	3,000	30,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	991,000	3,000	994,000
29	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,233,500	500	1,234,000
30	Gjykata Kushtetuese	83,000	0	83,000
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	85,000	7,000	92,000
35	Drejtoria e Pergjithshme e Doganave	829,000	401,000	1,230,000
37	Drejtoria e Pergjithshme e Standartizimit	26,300	700	27,000
40	Partite Politike	200,000	0	200,000
41	Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve	1,161,000	479,000	1,640,000
48	Drejtoria e Metrologise dhe Kalibrimit	33,000	0	33,000
50	Instituti Statistikes	127,000	8,000	135,000
53	Komisioni i Letrave me Vlere	22,000	1,000	23,000
55	Shkolla e Magjistratures	52,100	900	53,000
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	580,000	1,694,567	2,274,567
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	81,700	600	82,300
59	Instituti i Integritimit te Perndjekurve Politik	24,900	0	24,900
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	77,000	0	77,000
66	Avokati i Popullit	72,000	q	72,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	44,900	0	44,900
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	600,000	0	600,000
75	Avokati i Shtetit	82,000	0	82,000
76	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	79,000	0	79,000
77	Autoriteti i Konkurences	34,000	0	34,000
78	Ministria e Integritimit	113,000	3,125	116,125
79	Komiteti Shtetor i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	495,000	0	495,000
82	Keshilli Kombetar Kontabilitetit	14,300	700	15,000
83	Drejtoria e Pergjithshme e Parandalimit te Pastrimit te Parave	55,000	0	55,000
84	Inspektorati i Instituteve Private te Pensioneve Supplementare	10,000	0	10,000
	Totali	144,936,222	25,568,316	170,504,538

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Tab.1.1

ne 000 Lek				
Kodmin	Institucionet e Pavarura	Nr. Punonjesve	Paga 600+601	Buxheti Total
1	Presidenca	66	64,000	144,000
2	Kuvendi	414	442,000	962,000
24	Kontrolli Larte i Shtetit	160	185,000	235,000
28	Prokuroria e Pergjithshme	800	800,000	994,000
29	Zyra e Administrimit Buxhetit Gjyqesor	1,230	940,000	1,234,000
30	Gjykata Kushtetuese	45	58,000	83,000
53	Komisioni i Letrave me Vlera	15	0	23,000
55	Shkolla e Magjistratures	22	21,000	53,000
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	48	57,000	77,000
66	Avokati i Popullit	45	50,000	72,000
67	Komisioni i Sherbimit Civil	28	31,900	44,900
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	60	74,000	600,000
76	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	35	50,000	79,000
77	Autoriteti i Konkurences	20	22,000	34,000
79	Komiteti Shteteror i Kthimit dhe Kompensimit te Pronave	160	150,000	495,000

(Ndryshuar me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006)

Tab.2

ne 000 Lek					
Kodmin	Investimet e vitit 2006 sipas Ministrive dhe Institucioneve (ne 000 Lek)	Nga Buxheti	Nga te Ardhurat	Financimi Huaj	Totali
1	Presidenca	20,000	0	0	20,000
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	20,000	0	0	20,000

2	Kuvendi	240,000	0	0	240,000
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	240,000	0	0	240,000
3	Keshilli Ministrave	165,000	0	495,000	660,000
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	75,000	0	0	75,000
012	Administrata Publike	90,000	0	495,000	585,000
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	393,800	7,200	3,575,000	3,976,000
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	87,300	2,000	1,275,000	1,364,300
092	Mbeshtetje per Energjine	15,000	5,000	2,300,000	2,320,000
113	Mbesht. Gjeoshkenc e te tjera	210,000	200	0	210,200
114	Mbesht. Miniera e Ndje Publike	80,000	0	0	80,000
133	Mbeshtetje e Zhvill. Ekonomik	1,500	0	0	1,500
5	Ministria e Bujqesise, Ushqimit dhe Mrojtes se Konsumatorit	1,290,800	27,200	1,715,500	3,033,500
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	30,000	0	0	30,000
102	Sherbimet e Insp. Bujq. Sig Ushq. e Mbr. Konsum.	43,500	2,000	222,000	267,500
104	Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit	836,000	24,500	1,102,500	1,963,000
105	Mbesh.e prodh. Bujq, blek, agroind, dhe market.	311,300	0	383,000	694,300
106	Kerkimi dhe Ekstensionit	10,000	700	0	10,700
107	Menaxhimi i burimeve natyrore	50,000	0	0	50,000
108	Zhvillimi i Integruar Rural	10,000	0	8,000	18,000
6	Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	20,145,810	14,190	7,146,500	27,306,500
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	15,000	0	0	15,000
122	Rrjeti i rrugeve nacionale	15,424,484	0	3,621,000	19,045,484
123	Manaxhimi i Transportit Rugor	14,460	1,500	0	15,960
124	Portet	290,430	0	500,000	790,430
125	Hekurudhat	351,000	0	0	351,000
126	Aviacioni Civil	72,500	0	0	72,500
077	Ujesjelles Kanalizime	2,756,986	12,690	2,697,900	5,467,576
078	Strehimi dhe Urbanistika	620,950	0	327,600	948,550
139	Infrastruktura Turisitke	600,000	0	0	600,000
070	Sherbimet publike	0	0	0	0
9	Regjistrimi i Pasurive te Paluajtshme	0	100,000	0	100,000
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	0	100,000	0	100,000
10	Ministria e Financave	68,000	0	20,960	88,960
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	68,000	0	20,960	88,960
012	Zbatimi i Vendimeve Gjyqesore	0	0	0	0
013	Pagesa te menjehershme	0	0	0	0
014	Mbeshtetje e Institucioneve Financiare	0	0	0	0
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	3,254,000	660,000	1,218,000	5,132,000
011	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	60,500	4,000	50,000	114,500
042	Arsimi Baze (perfshire parashkollorin)	1,812,000	0	658,000	2,470,000
043	Arsimi i Mesem (i pergjithshem)	700,000	0	350,000	1,050,000
044	Arsimi i Mesem (profesional)	362,500	4,000	90,000	456,500
045	Arsimi Universitar	214,000	650,000	70,000	934,000
046	Programet Ars. dhe Trainimi i Mesuesve	5,000	2,000	0	7,000
047	Fonde per Shkencen	100,000	0	0	100,000
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	458,000	22,000	237,000	717,000
